

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC**/Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me sekretaren juridike Shemsije Shehu, në lëndën penale kundër të akuzuarve M. Th. nga fshati X., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së dhe L. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.03/2018 të datës 09.03.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me datë 31.05.2018, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.03/2018 të datës 09.03.2018, andaj gjykata jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

**Të akuzuarit:**

- 1. M. TH.**, i lindur me dt. ..., në fshatin X., Komuna e Rahovecit, ku edhe banon, nga i ati H. dhe e ëma Sh., e gjinisë F., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion hoteleri, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 2. L. B.**, i lindur me dt. ..., në Prishtinë, me banim në Gjakovë, Rr. “D. e M.”, nr. 23, nga i ati K. dhe e ëma R., e gjinisë B., i martuar, ka të kryer Fakultetin Juridik, i papunësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**I akuzuari: M. Th.**

**ËSHTË FAJTOR**

**S e p s e:**

Me dt. 10.12.2017 rreth orës 19:00, në fshatin Xërxë, Komuna e Rahovecit, sakësisht në restorantin “D.”, pronë e të dëmtuarit, i shkakton lëndime të lehta trupore të cilat rezultojnë me

dëmtime të përkohshme të shëndetit të dëmtuarit F. Q., në atë mënyrë që kur i dëmtuari i tregon të pandehurit se dëshiron ta lë punën si këngëtar në lokalin e tij dhe të shkoj për të kënduar në lokalin “J.”, i pandehuri revoltohet dhe e sulmon fizikisht, duke e kapur për krahu dhe duke e shtyrë, ku nga kjo shtyrje është përplasur me një derë, me ç’rast i shkakton lëndime të lehta trupore, të cilat lëndime më gjerësisht janë të konstatuara më hollësisht në ekspertizën mjekoligjore të Dr. N. U. të dt. 25.01.2018.

**Këso dore ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nënpar.1.4 të KPRK-së.**

**I akuzuari: L. B.**

### **ËSHTË FAJTOR**

**S e p s e:**

Me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në pjesën e 1 të dispozitivit të aktakuzës, i kanoset seriozisht të dëmtuarit F. Q., në atë mënyrë që ditën kritike i dëmtuari e kishte njoftuar të pandehurin M. Th. se do ta lë punën si këngëtar në lokalin e tij dhe do të shkoj diku tjetër, e kur i pandehuri L. dëgjoi se i dëmtuari do ta lë punën i kanoset seriozisht me fjalët “**se kam me te vra nëse shkon diku tjetër të këndosh**”, me ç’rast te i dëmtuari shkakton frikë dhe ankth.

**Këso dore ka kryer veprën penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 41, 46, 73, 188 të KPRK-së, nenit 365 dhe 493 të KPPK-së, të akuzuarve i’u shqipton:

### **D Ë N I M M E G J O B Ë**

Të akuzuarit **M. Th.**, në shumën prej dyqind (200) euro, të cilin dënim i akuzuari obligohet që ta paguajë në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit **L. B.**, në shumën prej dyqind (200) euro, të cilin dënim i akuzuari obligohet që ta paguajë në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund ta paguajnë gjobën sipas nenit 46 të KPRK-së, e njëjta do të i’u zëvendësohet në dënim me burgim për secilin të akuzuar në kohëzgjatje prej dhjetë (10) ditëve, duke llogaritur çdo ditë të burgimit me nga njëzet (20) euro.

I dëmtuari F. Gj. Q. nga fshati U., Komuna e Gjakovës, udhëzohet që kërkesën pasurore–juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile.

Obligohen të akuzuarit që në mënyrë solidare të paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të ekspertizës mjekoligjore shumën prej 20.44 euro, si dhe në emër të

shpenzimeve paushalle të paguajnë shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm kësaj gjykate ia ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.03/2018 të datës 09.03.2018, kundër të akuzuarve M. Th. nga fshati X., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së dhe L. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së, si dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga ana e të akuzuarit.

Gjykata pas shqyrtimit të kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhrin ndëshkimor në kuptim të nenit 493 paragrafi 1 të KPPK-së.

Gjykata duke i vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: Raporti i oficerit policor R. K. me nr.2017-EB-490 i dt. 12.12.2017; deklarata e të pandehurve dhe të dëmtuarit dhënë në P.TH. në Gjakovë; ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. N. U. e dt. 25.01.2018, foto-dokumentacioni dhe shkresat e tjera të lëndës, gjykata konstaton se këto prova janë bindëse, të besuara dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen, prandaj gjykata të njëjtit i shpalli fajtorë dhe i gjykoi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurën civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor bazohet në nenin 450 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr.116/18 me datë 31.05.2018**

**Sekr. juridike**  
**Shemsije Shehu**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Mizahir Shabani**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimit mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit, për Gjykatën Themelore Gjakovë – Dega Rahovec.